



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

Numri i lëndës: 2023:224695  
Datë: 10.10.2024  
Numri i dokumentit: 06281847

**K.DH.SH.II.nr.860/24**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS** - Dhoma e Shkallës së Dytë, me gjyqtaren Franciska Zhitija Ymeri, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Inspektorati i Punës, me seli në Prishtinë, kundër debitorit “Radio Televizioni i Kosovës” SH.A., me seli në Prishtinë, rruga “Xhemajl Prishtina”, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1688/23 të datës 31.01.2024, me datën 08.10.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** e pabazuar ankesa e debitorit “Radio Televizioni i Kosovës” SH.A., me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1688/23 të datës 31.01.2024, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.1688/23 të datës 31.01.2024, ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit “Radio Televizioni i Kosovës” SH.A., i paraqitur kundër

Urdhrit Përbarimor P.nr.702/2023, të datës 07.10.2023, të Përbaruesit Privat Saranda Rexhepi.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka paraqitur ankesë debitori, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës përbarimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovoj ankesën si të bazuar.

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përbarimore (LPP), gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se Përbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Inspektorati i Punës, ka lëshuar Urdhrin Përbarimor P.nr.702/2023, të datës 07.10.2023, me të cilin ka lejuar përbarimin në bazë të dokumentit përbarimor - Aktvendimit të Inspektoratit të Punës Nr.01/08-03/2023-A të datës 10.02.2023, me të cilin është detyruar debitori që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit, t'ia paguaj kreditorit në emër të masës ndëshkimore shumë prej 3,000.00 €, si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka theksuar se e kundërshton në tërësi urdhrin përbarimor pasi që i njëjti është përpiluar në kundërshtim me nenin 22 dhe 29 të LPP-së, pasi që në asnjërin prej tyre nuk specifikohet se inspektorati i punës si organ i cili nxjerr vendime e i cili do të krijonte dokumente të besueshme përbarimore. Tutje ka shtuar se vendimi i bashkangjitur si dokument përbarimor nuk ka titull ekzekutiv, e as tipare të përbarueshmërisë, përveç kësaj në vendim është e specifikuar tek këshilla juridike afati i ngritjes së konfliktit administrativ në afat prej 30 ditësh, andaj debitori brenda afatit ligjor ka ngritur konflikt administrativ. Gjykatës i ka propozuar që të pranohet si i bazuar në tërësi prapësimi i debitorit, ndërsa urdhri përbarimor të anulohet.

Kreditore me përgjigje në prapësim ka deklaruar se nuk qëndrojnë pretendimet e debitorit, duke theksuar se urdhri për përmbartim është në përputhje me dispozitat ligjore të LPP-së, ndërsa sa i përket pretendimit se debitori ka ushtruar padi pranë gjykatës kompetente, ka shtuar se vendimet e TEIP janë të ekzekutueshme dhe ushtrimi i padisë në konflikt administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit. I ka propozuar gjykatës që prapësimi i debitorit të refuzohet, ndërsa urdhri për përmbartim të mbetet në fuqi

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar pas vlerësimit të prapësimi ka nxjerrë aktvendimin KPPP.nr.1688/23 të datës 31.01.2024, me të cilin ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit “Radio Televizioni i Kosovës” SH.A., i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.702/2023, të datës 07.10.2023, të Përmbartuesit Privat Saranda Rexhepi.

Në arsyetim të aktvendimit gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se në rastin konkret Aktvendimi Nr.01/08- 03/2023-A i datës 10.02.2023, në bazë të së cilit përmbartuesi privat ka lejuar përmbartimin dhe gjeti si i njëjti, sipas nenit 22 paragrafit 1, nën paragrafi 1.2 të LPP-së, është përcaktuar si dokument përmbartues sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla. Gjykata gjeti se Aktvendimi Nr.01/08-03/2023-A i datës 10.02.2023, i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 27 paragrafin 1, sipas të cilit: “Dokumenti përmbartimor është i përshtatshëm për përmbartim në qoftë se në të është treguar kreditore dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”, pasi që i njëjti përmban të dhënat për kreditorin dhe debitorin, shumën të cilën e ka obligim ta paguaj debitori dhe kohën e përmbushjes së detyrimit.

Gjykata Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata Komerciale, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i ankimuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së, dhe se drejtë është

vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbaremore kur ka refuzuar prapësimin e debitorit të paraqitur kundër urdhrin të përmbaruesit privat, me të cilin është caktuar përmbarimi i propozuar nga kreditori.

Kjo gjykatë vlerëson se Aktvendimi Nr.01/08- 03/2023-A i datës 10.02.2023, është dokument përmbarues dhe i përshtatshëm për përmbarim, për faktin se me nenin 22 paragrafi 1 pika 1.2 të LPP-së, përcaktohet se: “ *Dokument përmbarues është edhe vendimi përmbarues i dhënë në procedurë administrative dhe akt pajtimi (me tej: ujdia)* ” dhe përbënë bazën juridike për caktimin e përmbarimit sipas nenit 21, duke i plotësuar kushtet nga neni 24 paragraf 3 sepse, po ashtu është në pajtim edhe me nenin 27 paragraf 1 të LPP i cili përcakton se: “ *Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit* ”, ndërsa një dokument përmbarimor për të shërbyer si titull përmbarues patjetër duhet të përmbajë elementet e përcaktuara me nenin 27 paragrafi 1, të cilat e bëjnë si dokument të përshtatshëm përmbarimor. Në bazë të këtij neni del se kushtet në fjalë duhet të plotësohen në mënyrë kumulative dhe se mungesa e vetëm njërit prej këtyre kushteve, e bënë dokumentin përkatës përmbarimor të papërshtatshëm për përmbarim. Me shikim në shkresat e lëndës konstatohet se Aktvendimi Nr.01/08- 03/2023-A i datës 10.02.2023, është dokument i përmbarueshëm dhe i cili vendim është bërë i formës së prerë me datë 03.05.2023 dhe i ekzekutueshëm me datë 03.05.2023, ashtu që si i tillë është i vlefshëm juridikisht dhe i përshtatshëm për përmbarim, pasi që i njëjti i plotëson të gjitha kushtet ligjore, ku në të është treguar kreditori dhe debitori, është përcaktuar saktë lartësia e detyrimit të debitorit, objekti, lloji, vëllimi dhe koha e përmbushjes së detyrimit nga ana e debitorit.

Gjykata e shkallës së dytë ka vlerësuar edhe nenin 36 paragraf 1 të LPP - së, ku përcakton se;

“ *Së bashku me propozimin për përmbarim, organit përmbarues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarues origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarueshmërisë për përmbarueshmëri* ”, ndërsa në paragrafin 2, të po këtij neni përcaktohet se “ *Vërtetimin për*

*përmbarueshmëri e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë ”. Në rastin konkret kemi të bëjmë me vendim administrativ të formës së prerë, i njëjti është origjinal dhe si i tillë i plotëson kushtet për përmbarim.*

Kjo gjykatë vlerësoj pretendimet ankimore të debitorit lidhur me at se organi mund ta shtyjë ekzekutimin e vendimit nëse i njëjtit nuk është në kundërshtim me interesin publikë ashtu sipas nenit 22 paragrafi 2 dhe 5 të LKA-së, , por i refuzoj si të pa bazuar për shkak se këto dispozita i referohen në rastin e paraqitjes së kërkesës për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit kontestues në procedurën administrative dhe gjyqësore e jo në procedurën përmbarimore e për më tepër debitori nuk ka argumentuar me ndonjë aktvendim të gjykatës kompetente se është vendosur lidhur me shtyrjen e ekzekutimit të vendimit kontestues, po ashtu nuk qëndron as pretendimi tjetër lidhur me shtyrje e propozimit për përmbarim ngase një propozim i till është dashur që debitori të paraqitë pranë gjykatës së shkallës së parë dhe at duke domenstruar se ka mundësi bindëse për të qenë i sukseshëm në ankesë, e cila do të gjente zbatim sipas nenit 61 paragrafi 1 të LPP-së, andaj të gjitha pretendimet tjera ankimore janë të pa bazuar për shkak se të njëjtat nuk janë objekt shqyrtimi i procedurës përmbarimore kështu që nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë sepse kjo procedurë i nënshtrohet parimit të formalitetit rigoroz, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit objekt përmbarimi.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkallës së Dytë  
K.DH.SH.II nr.860/24, me datë 08.10.2024

Gjyqtarja,  
Franciska Zhitija Ymeri